

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 928 Prot.

Tiranë, më 16.04.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 24, datë 16.04.2025

**“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE PËR
VITIN 2025, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, e ndryshuar, Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të MFE-së dhe Ministrit të MASR-së nr.20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”, VKM-së nr.386 datë 01.06.2022 “Për miratimin e fushave dhe programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programme në institucionet publike të arsimit të lartë”, e ndryshuar, Udhëzimit të MAS-së nr.30 datë 04.11.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programme studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, Shkresës së AKFAL NR.58/35 prot., datë 05.03.2025, Shresës së MF-së nr.4734/1 prot., datë 25.03.2025, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.585/37 prot., datë 15.04.2025 “Kërkesë për miratim të shpërndarjes së fondeve buxhetore, për studentët e shkëlqyer të UMT-së, të cilët përfitojnë mbështetje financiare për programet e studimit të cilat përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik 2024-2025”,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2025, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANETARË

VERA OSTREMI

ALTINA XHAFFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

Nr. 585/37 Prot

Tiranë, më 15.04.2025

Lënda: Kërkesë për miratim të shpërndarjes së fondeve buxhetore, për studentët e shkëlqyer të UMT-së, të cilët përfitojnë mbështetje financiare për programet e studimit të cilat përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik 2024-2025.

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

E nderuar Kryetare,

Të nderuar Anëtarë të Bordit të Administrimit,

Në zbatim të VKM-së nr.386 datë 01.06.2022 *"Për miratimin e fushave dhe programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programme në institucionet publike të arsimit të lartë"*, e ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të MAS-së nr.30 datë 04.11.2022 *"Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programme studimi që përbëjnë prioritet kombëtar"*, ka përfunduar nënshkrimi marrëveshjeve trepalëshe me studentët e shkëlqyer të UMT-së, fitues të mbështetjes financiare për vitin akademik 2024-2025.

Nga AKFAL janë përcjellë marrëveshjet përkatëse të nënshkruara, të cilat u nënshkruan edhe nga studentët dhe Administratori i UMT-së.

Për vitin akademik 2024-2025 janë 35 studentë fitues të cilët nënshkruan marrëveshjen trepalëshe. Sa më sipër, përfitojnë mbështetjen financiare 30 studentë të Fakultetit të Mjekësisë, dega *"Mjekësi e Përgjithshme"*, 4 studentë të Fakultetit të Mjekësisë Dentare dega *"Stomatologji"* dhe 1 student i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dega *"Infermieri e përgjithshme"*.

Për studentët përfitues nga MAS janë shpërndarë fonde buxhetore në buxhetin e vitit 2025 në vlerën 14,760,000 (katërmëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Nga AKFAL sqarohet se, studenti i cili përfiton mbështetje financiare sipas parashikimeve të VKM-së 386, datë 01.06.2022, e ndryshuar, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe përfitues i ndonjë financimi tjetër nga UMT.

Në rastet kur studenti ka përfitur bursë sipas parashikimeve të VKM-së 903 datë 21.12.2016, e ndryshuar, nga kjo mbështetje do ti zbritet financimi i bursës i kryer deri në atë moment dhe studenti do të përfitoj diferencën.

Po ashtu, studenti i cili përfiton mbështetje financiare sipas VKM-së 386, datë 01.06.2022, e ndryshuar, përjashtohet nga tarifa vjetore e shkollimit. Nëse ka raste që studenti ka paguar ndërkohë tarifën e shkollimit dhe është përfitues i mbështetjes financiare, vlera e tarifës së paguar do ti rimbursohet përsëri studentit.

26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor". Udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor", në përputhje me rregullat dhe standartet e menaxhimit financiar publik, kërkohet miratimi i shpërndarjes së grantit të akorduar për njësitë shpenzuese të UMT-së, sipas tabelave bashkëlidhur.

Po ashtu bashkëngjitur këtij relacioni, lutemi gjeni:

-Shkresë dërguar nga AKFAL nr.58/35 prot., datë 05.03.2025 "Mbi dërgimin e marrëveshjeve trepalëshe për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas VKM-së nr.386/2022, i ndryshuar, nënshkruar për vitin akademik 2024-2025";

-Email-in e MAS-së, datë 15.04.2025, ku përcillet shkresat e MFE-së nr.4734/1 prot., datë 25.03.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE-së, si dhe limitet mujore të shpenzimeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

ADMINISTRATOR
ARLIND BROCI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 4734/9 Prot.

Tiranë, më 03.03.2025

Lënda: Dërgohet detajimi i grantit për vitin 2025.

DEGËS SË THESARIT _____

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

Për dëgjim: MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT ✓

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si dhe të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr.1438/1 Prot., datë 10.03.2025, përmes së cilës kërkohet shpërndarja e grantit në zbatim të Vendimit nr. 1 dhe nr.2, datë 17.02.2025 të Bordit Drejtues të AKFAL, ju dërgojmë detajimin e grantit me qëllim mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer të cilët ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar për vitin 2025, sipas tabelës bashkëlidhur.


Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Florian nurce
Perpeshis Sektor | Head Of Unit
Dreptoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar | Directorate of Budget and
Financial Management
Ministria e Arimit dhe Sportit | Ministry of Education and Sports
(A) Rruga e Dureses, Nr 25, Tiranë, Shqipëri
(E) florian.nurce@shqiperia.gov.al

ARQ: 01_01_2024_12
5:12:26 PM
10.0.0.1/2024-12-01



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
DREJTORIA E E GRANTEVE

Nr. 585/2025 Prot.

Tirane, me 05.03.2025

Lënda: Mbi dërgimin e marrëveshjeve trepalëshe për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, nënshkruar në vitin akademik 2024-2025.

UNIVERSITETI TË MJEKËSISË, TIRANË
Adresa: Rruga e "Dibrës", Nr. 371, 1005, Tirane

I nderuar,

Në mbështetje të pikës 7 të Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të maseve dhe mënyrës së financimit të studenteve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbejnë prioritet kombëtar", i ndryshuar, pas nënshkrimit të marrëveshjeve, bashkëlidhur ju përcjellim për protokollim marrëveshjet tre-palëshe (AKFAL - Student-LMI).

Ne përfundim, lutemi nga ana juaj të përcillni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë një kopje të secilës marrëveshjeje, si dhe nga ana juaj t'i dorëzohet kopja çdo studenti përfitues të mbështetjes financiare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Edlira Përfundi



Tabela nr 1: Ndaria e Grantit për vitin 2025 " Bursa të studentëve ekselentë dhe në programe prioritare" për Universitetin e Mjekësisë Tiranë

Në Lekë

nr.	Min.	Luj	Kod		Emer Inst	Kap	Prog	U log		Output kod	Kodi i Degës		Debiti
			Ins					Ek			Thesarit		
01	11		1011199		Universiteti i Mjekësisë Tiranë	08	09770	60600000		91106/AF		3535	14,760,000
					Shtesa								14,760,000
01	11		1011139		Fakulteti i Mjekësisë	08	09770	60600000		91106/AF		3535	12,760,000
01	11		1011200		Fakulteti i Mjekësisë Dentare	08	09770	60600000		91106/AF		3535	1,600,000
01	11		1011202		Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	08	09770	60600000		91106/AF		3535	400,000

Tabela nr 3: Ndaria në Limite Mijore e Grantit për vitin 2025 " Bursa të studentëve ekselentë dhe në programe prioritare" për Universitetin e Mjekësisë Tiranë

Në Lekë

nr.	Min.	Luj	Kod		Emer Inst	Kap	Prog	U log		Output kod	Kodi i Degës		Debiti
			Ins					Ek			Thesarit		
	11		1011139		Fakulteti i Mjekësisë	08	09770	60600000		91106/AF		3535	12,760,000
	11		1011200		Fakulteti i Mjekësisë Dentare	08	09770	60600000		91106/AF		3535	1,600,000
	11		1011202		Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	08	09770	60600000		91106/AF		3535	400,000

TETI MJEKËSISË

Ndarja në Limite Mijore e Grantit për vitin 2025 " Bursa të studentëve ekselentë dhe në programe prioritare"për Universitetin e Mjekësisë Tiranë

Qev	Min.LnJ	Kod.Inst	Emer Institucionit	Kap	Tipi i Qev.	Llog.Ek	Output KOD	TDO	DEBI	KREDI
001	11	1011199	Rektorati	01	001	6029999	91106AF	3535		14,760,000
001	11	1011139	Fakulteti i Mjekësisë	01	001	6029999	91106AF	3535	12,760,000	
001	11	1011200	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	01	001	6029999	91106AF	3535	1,600,000	
001	11	1011202	Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike	01	001	6029999	91106AF	3535	400,000	
			TOTALI						14,760,000	14,760,000

001	11	1011199	Rektorati	01	001	6029999	91106AF	3535		14,760,000
001	11	1011139	Fakulteti i Mjekësisë	01	001	6029999	91106AF	3535	12,760,000	
001	11	1011200	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	01	001	6029999	91106AF	3535	12,760,000	
001	11	1011202	Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike	01	001	6029999	91106AF	3535	1,600,000	
			TOTALI						27,120,000	14,760,000